

## VENDIM

Nr. 876, datë 30.10.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 758, DATË 15.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT, SI DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Në vendimin nr. 758, datë 15.9.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

"1. Përzgjedhja e katër anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, bëhet nga ministria përgjegjëse për ekonominë".

2. Pika 2 e vendimit, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**